

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, KAKAVIE

Kontrolli i Lartë i Shtetit përfundoi auditimin në Degën e Doganës Kakavie, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën e veprimtarisë viti 2012 deri 2013, duke u përqendruar në realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Kakavie me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën 2012-2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 120, datë 19.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresat nr. 578/16, datë 19.09.2014 dhe nr. 578/17 datë 19.09.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Ilir Mino, Kryetar i Degës Doganës, Kakavie.

Nga ky auditim, u konstatuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore, ku më kryesoret janë:

1. Mospërputhje në procedura dhe të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative që rregullojnë funksionimin e Degës Doganore, si në drejtim të procesit të vlerësimit e pranimit të deklaratave doganore të subjekteve të biznesit dhe individëve, ashtu dhe në drejtim të administrimit material e financiar, të cilat kanë sjellë për pasojë **një dëm financiar dhe mungesë të ardhurash për Buxhetin e Shtetit në shumën 72,206,897 lekë.**

2. Mosregjistrimi i te gjitha mjeteve të huaja, për realizimin e të ardhurave dytësore për tarifën e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve me më shumë se 20 persona, që përcaktohet me reciprocitet prej 45 euro për çdo hyrje dalje, në bazë të shkresës të DPD-së nr. 14969/1 prot, datë 17.12.2008, “Lista e shteteve, Transportuesit e të cilëve duhet të paguajnë tarifën e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë”. Nga të dhënat e marra për numrin e automjeteve të hyra për çdo datë të punës së turnit për 24 orë, të dhëna këto të nxjerra nga sistemi TIMS, ballafaquar me dokumentacionin e arkëtimit të paraqitur nga zyra e financës të doganës, si dhe akordimeve të bëra me punonjësit përgjegjës, rezultoi se doganierë të pikës, së hyrje daljes nuk shënonin në regjistër të gjitha mjetet, duke sjellë një diferencë të pa arkëtuar në total me dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit **në vlerën e 120,195 euro për 2.671 raste në periudhën 2012-2013.**

3. Mozbatimi dhe mosarkëtimi i tarifave të parkingut. Për arkëtimin e tarifës së qëndrimit në parkim të automjeteve në vlerat 1000 lekë/dita për mjetet me tonazh mbi 10 ton dhe 500 lekë/dita për mjetet me tonazh deri në 10 ton, kjo në bazë të shkresës të DPD-së nr. 13119 prot. datë 02.11.2006 “Mbi caktimin e tarifave të të ardhurave dytësore në Administratën Doganore”, nga të dhënat e marra në regjistrat e parkingut për numrin e automjeteve të hyra në parkim për çdo datë të punës së turnit prej 24 orë, rezultojnë se në shumë raste nuk janë zbatuar e arkëtuar tarifat e parkingut nga punonjësit doganierë të caktuar sipas grafikut të shërbimit, duke krijuar **një dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit, për 4,334,600 lekë në periudhën 01.06.2012-31.12.2013.**

4. Praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion nga sektori i vlerës, jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim;

5. Praktika doganore me grup artikujsh nga i njëjti eksportues të cilat janë trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0%, në shkelje të nenit 22 të Ligjit nr.9590, datë

27.07.2006, të MSA të RSH dhe KE, hyrë në fuqi më 01.04.2009; protokolli 4 lidhur me Përkufizimin e Konceptit të “Produkteve Origjinuese” dhe “Mbi rregullat e origjinës preferenciale”.

6. Praktika doganore ku sektori i vlerës ka vepruar jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-37 të Kodit Doganor si dhe jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, pika 5.4, “Në rastet e importit të mallrave të përdorura nga Dega Doganore të ngrihet Komision për vlerësimin e tyre që duhet të përcaktojë shkallën e amortizimit të mallrave për të cilat bazë llogaritjes duhet të jenë vlera referuese, viti i prodhimit, dhe vlera e llogaritur nuk mund të jetë më e vogël se 30% e vlerës së mallit të ri”.

7. Praktika doganore ku sektori i vlerës ka vepruar në kundërshtim të neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe në shkelje të kërkesave të pikës 5.2 të Sesionit I të Udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, “Në rastet kur për mallin e deklaruar nuk është e mundur të gjendet në “Dosjen e të Dhënave të Disponueshme”

8. Praktika doganore ku sektori i vlerës ka vepruar jo në përputhje me kërkesat e Sesionit III “Zhdoganimin e automjeteve” të Udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave, i ndryshuar “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”.

9. Keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, në shkelje të neneve 256.1/a, 256.2 dhe 261.1 të Kodit Doganor.

10. Praktika doganore me probleme të të njëjtit subjekt, të përpunuar nga i njëjti doganier vlere si dhe praktika doganore, ku edhe pse artikulli është në bursë, procedurat e zhdoganimit janë kryer me transaksion.

Shumica e praktikave doganore nuk janë të plotësuara me të gjithë treguesit e specifikuar, me të dhënat në kuadratet përkatëse nga personeli doganor që ka përpunuar praktikën doganore, por pasqyrohen vetëm nënshkrimi e vula, pa evidentuar emër e mbiemër, apo në raste të veçanta, edhe asnjë prej tyre, veprime që nuk përputhen me kërkesat e legjislacionit doganor.

Për këto shkelje dhe shkelje të tjera të konstatuara, **KLSH ka kallëzuar në Prokurori 8 punojës me detyrë doganierë të kontrollit fizik pikë-hyrje dhe të parkingut doganor, N.S, N.P, D.D, K.S, A.Q, K.D, L.V, F.D në Degën e Doganës Kakavie**, të cilët në mos përmbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën” parashikuar nga neni 135 i ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë”. KLSH i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër materialet e auditimit dhe të gjitha provat përkatëse.

Për të gjithë doganierët e rezultuar me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit, KLSH i ka propozuar Drejtores së Përgjithshme të Doganave të marrë masat disiplinore nga “largim nga shërbimi civil” deri “mbajtje deri në 1/3 e pagës”.

Gjithashtu, KLSH ka rekomanduar, 7 masa organizative, 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën **66,328,917 lekë** si dhe 2 masa administrative penalitet për 2 subjekte.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Agron Opari, p/grupi, Xhovani Domi dhe Anesti Gjika, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT